



Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr.04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt.22 Nëntor 2012, nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjilanit, për qëllimin e rregullimit të infrastruktures rrugore, pas Rekomandimit të Komitetit për Pronë dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, për këmbimin e pronës komunale me pronën private, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me date 29.09.2014, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të rrugës publike –Shkolla e Zabelit

1. Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevoja të rrugës publike –Shkolla e Zabelit** , Zona Kadastrale Gjilan.
2. Lejohet këmbimi i ngastrave kadastrale: P-70403013-01068-5, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 247 m², te vendi i quajtur “Prroni i kollarit”, lloji i shfrytëzimit – infrastruktur, shfrytëzimi aktual i parcelës – rrugë, ngastra P-70403013-01074-9, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 620 m², te vendi i quajtur “Prroni i kollarit”, lloji i shfrytëzimit – infrastruktur, shfrytëzimi aktual i parcelës – rrugë, ngastra P-70403013-01070-7, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 245 m², te vendi i quajtur “Prroni i kollarit”, lloji i shfrytëzimit – infrastruktur, shfrytëzimi aktual i parcelës – rrugë. Sipërfaqja e përgjithshme e ketyre ngastrave është 1112 m² dhe evidentohet në emër të pronarit Haki Dërmaku (Hasan) me 1/1 të pjesës së pronës.

Pronat private të cekura më lartë të këmben me pronën komunale : P-70403013-01057-0, lloji i njësisë parcelë, lloji pronës – shoqërore, zona urbane, sipërfaqja 1223 m², vendi i quajtur “ Mullini i Arapit”, lloji i shfrytëzimit- rajon ujqor e cila evidentohet në emër të P.Sh. Ujrat Kuvendi i Komunës Gjilan dhe gjindet në afërsi me ngastrat të cilat janë objekt këmbimi.
3. Obligohet Kryetari i Komunës, që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi të bëjë kërkesë Ministrisë për Financa-ZVPP për vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit dhe të lidhin Kontratë për këmbimin me pronarin privat të cekur në nenin II të këtij vendimi duke u bazuar në raportet e vlerësimit nga Ministria përkatëse.

4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bënë parcelimin e ngastrës Komunale sipas raportit të vlerësimit dhe pas lidhjes së kontrates mes Kryetarit të Komunës dhe pronarit privat të bënë regjistrimin e pronave të këmbyera në Regjistrat Kadastral.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.
6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 016-112989
Gjilan, më 29.09.2014

Kryesuesja e Kuvendit

/Valentina Bunjaku –Rexhepi/